



Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 qershor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënie të Dëshmisë nga W04445 dhe
W04501 përmes Videokonferencës**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiq

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(2) dhe (4)(f), 23(1) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 141(1) dhe 144 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 12 qershor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dorëzoi kërkesën që Trupit Gjykses të autorizonte marrjen e dëshmive të W04445-ës dhe W04501-shit përmes lidhjes me videokonferencë nga një vend i përshtatshëm (Kërkesa).¹ ZPS-ja parashtron se dëshmia përmes videokonferencës: (i) është e nevojshme dhe e përshtatshme për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e dëshmitarëve dhe për të lehtësuar dhënien sa më shpejt të dëshmive; dhe (ii) nuk do të cenonte në mënyrë të papërligjur të akuzuarit sepse Mbrojtja do të jetë në gjendje të marrë në pyetje dëshmitarët.² ZPS-ja parashtron se si dëshmitarë rezervë, W04445 mund të paraqitet që në 27 qershor 2024, ndërsa W04501 që në 4 korrik 2024.³

2. Më 19 qershor 2024, në zbatim të urdhrit të Trupit Gjykses për parashtrime të përsheptuara,⁴ Zyra Administrative dorëzoi vlerësimin mbi Kërkesën dhe konfirmoi mundësinë e realizimit të dhënies së dëshmisë së këtyre dëshmitarëve përmes lidhjes me video ("Vlerësim i Zyrës Administrative").⁵

3. Mbrojtja nuk u përgjigj.

¹ F02378, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Dhënie të Dëshmisë nga W04445 dhe W04501 përmes Videokonferencës*, 12 qershor 2024, konfidenciale, para. 1 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02378/RED).

² Kërkesa, para. 1-2.

³ Kërkesa, para. 10, 14.

⁴ CRSPD525, *Email i Trupit Gjykses II drejtuar Palëve dhe Pjesëmarrësve në Lidhje me Përgjigje të Përsheptuara ndaj Parashtrimit F02378*, 13 qershor 2024, konfidencial.

⁵ F02392, Zyra Administrative, *Vlerësim i Zyrës Administrative lidhur me Kërkesën e Prokurorisë për Dhënie të Dëshmisë nga W04445 dhe W04501 nëpërmjet Videokonferencës*, 19 qershor 2024, konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua po atë ditë, F02392/CONF/RED).

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas rregullës 141(1), parimisht dëshmitarët e japin dëshminë duke qenë të pranishëm në gjyq. Trupi Gjykses mund të lejojë edhe që dëshmia e dëshmitarit të jepet përmes videokonferencës sipas rregullës 144 dhe në një mënyrë që nuk shkakton padrejtësi, apo që nuk është në mospërputhje me të drejtat e të akuzuarve.

5. Sipas rregullës 141(1) dhe (3) Trupi Gjykses mund të urdhërojë që dëshmia të jepet me videokonferencë me kusht që teknologjia të mundësojë që dëshmitari të pyetet si duhet. Trupi gjykses garanton që videokonferenca t'u mundësojë palëve dhe trupit gjykses t'i bëjnë pyetje dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë.

III. DISKUTIM

6. Trupi Gjykses rikujton se ka diskrecionin të autorizojë dhënien e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës nëse plotësohen kushtet e rregullës 144, megjithëse prania e dëshmitarit në sallën e gjyqit mbetet zgjedhja e preferuar.⁶

7. Trupi Gjykses thekson se kur vlerësohet nëse duhet lejuar përdorimi i videokonferencës, mund të merren në shqyrtim disa faktorë, përfshirë: (i) vendi; (ii) gjendja vetjake dhe shëndetësore e dëshmitarit; (iii) disponueshmëria dhe

⁶ *Shih p.sh., F02308, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënie të Dëshmisë përmes Videokonferencës nga W04305 dhe Kërkesën lidhur me Të, 14 maj 2024, konfidencial, para. 8 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02308/RED); F02181, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W04571 nëpërmjet Videokonferencës, 15 mars 2024, publik, para. 7; F01851, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dëshmi përmes Videokonferencës për W04448-ën dhe Çështje të lidhura me Të, 11 tetor 2023, para. 9 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F01851/RED); F01776, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W03827 nëpërmjet Videokonferencës ("Vendimi i 8 Shtatorit 2023"), 8 shtator 2023, konfidencial, para. 12 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 1 nëntor 2023, F01776/RED); KSC-BC-2020-07, Transkripti i Seancës, 14 janar 2022, f. 3034, rreshtat 2-5. Shih gjithashtu ICTY, *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-T, Trial Chamber II, [Decision on the Defence Motions to Summon and Protect Defence Witnesses, and on the Giving of Evidence by Video-Link](#), 25 June 1996, para. 19.*

siguria e dëshmitarit; dhe (iv) kompleksiteti dhe kohëzgjatja e çdo udhëtimi logjistik dhe përgatitjet e tjera që duhet të bëhen.⁷

A. W04445

8. Trupi Gjykses vë në dukje parashtrimet e ZPS-së se: (i) W04445 është në moshë të thyer dhe vuan nga probleme serioze shëndetësore; (ii) W04445 është i gatshëm të dëshmojë por nuk është në gjendje të udhëtojë me avion për shkak të gjendjes shëndetësore;⁸ dhe (iii) kohëzgjatja e marrjes në pyetje të W04445-ës nga Prokuroria nuk parashikohet të jetë më tepër se një orë.⁹ Gjithashtu Trupi Gjykses vëren se W04445 është dëshmitar rezervë për bllokun e ardhshëm të dëshmive, gjë që e bën disi të paqartë përcaktimin e saktë të kohës së dëshmisë së tij.¹⁰

9. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të Kërkesës dhe pasi ka vërejtur mungesën e kundërshtimit nga ana e Mbrojtjes, Trupi Gjykses bindet se ZPS-ja ka vërtetuar që gjendja vetjake dhe shëndetësore e dëshmitarit e bëjnë të domosdoshme dëshminë e tij me videokonferencë. Megjithëse statusi si rezervë i dëshmitarit nuk përbën në vetvete arsye për të pranuar kërkesën e dëshmisë përmes videokonferencës, Trupi Gjykses gjykon se në rrethanat për të cilat bëhet fjalë, duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të W04445-ës, videokonferenca është më e favorshme për mirëqenien e W04445-ës se sa transferimi i dëshmitarit në Hagë për të dëshmuar në sallën e gjyqit. Gjithashtu Trupi Gjykses gjykon se marrja e dëshmisë së dëshmitarit përmes videokonferencës mund të ndihmojë në shpejtimin e procesit.

10. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se dhënia e dëshmisë së W04445-ës përmes videokonferencës nuk do t'u shkaktojë dëm të akuzuarve dhe është në përputhje me mbrojtjen e efektshme të të drejtave të tyre, duke qenë se W04445 do

⁷ Vendimi i 8 Shtatorit 2023, para. 12; KSC-BC-2020-07, Transkripti i Seancës, 14 janar 2022, f. 3034, rreshtat 6-10. *Shih ngjashëm* KSC-BC-2020-04, F00482/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Dëshmi përmes Videokonferencës për TW4-04-ën, TW4-10-n dhe TW4-11-shin*, 13 prill 2023, para. 13-14.

⁸ Kërkesa, para. 7.

⁹ Kërkesa, para. 10.

¹⁰ Kërkesa, para. 3.

të merret në pyetje në kushte të njëjta si të ishte në sallën e gjyqit. Konkretisht Trupi Gjykses, të akuzuarit, palët dhe pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të shohin dhe të dëgjojnë dëshmitarin duke dhënë dëshmi drejtpërdrejt dhe do të kenë mundësi t'i bëjnë pyetje atij.

11. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton kërkesën e ZPS-së që W04445-a të japë dëshmi përmes videokonferencës.

B. W04501

12. Trupi Gjykses vë në dukje parashtrimin e ZPS-së se, ndonëse W04501 është i gatshëm dhe në dispozicion për të dëshmuar, mungesa e gjatë e W04501-shit, në qoftë se dëshmon në Hagë, mund të krijojë shqetësime për sigurinë e W04501-shit dhe më tepër stres.¹¹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se W04501 është dëshmitar rezervë për bllokun e ardhshëm të dëshmive, gjë që e bën disi të paqartë përcaktimin e saktë të kohës së dëshmisë së tij.¹²

13. Trupi Gjykses rikujton se siguria e dëshmitarit është një nga faktorët që shqyrton Trupi Gjykses kur vlerëson nëse do ta lejojë apo jo dhënien e dëshmisë me videokonferencë.¹³ Trupi Gjykses konstaton se parashtrimi i ZPS-së nuk jep të dhëna të detajuara që të mundësojë kryerjen e një vlerësimi të plotë të shqetësimeve të mundshme për sigurinë e dëshmitarit. Megjithatë, Trupi gjykses vëren edhe mungesën e kundërshtimit nga ana e Mbrojtjes për këtë kërkesë. Gjithashtu, nuk ka asnjë tregues që videolidhja e kërkuar do të dëmtojë të drejtat e të akuzuarve, duke qenë se Mbrojtja do të jetë në gjendje ta marrë dëshmitarin në pyetje në të njëjtat kushte si të ishte i pranishëm në sallë. Ashtu si edhe për W04445-en, Trupi Gjykses gjithashtu gjykon se marrja e dëshmisë së dëshmitarit përmes videokonferencës mund të ndihmojë shpejtimin e procesit.

¹¹ Kërkesa, para. 12.

¹² Kërkesa, para. 12.

¹³ *Shih* para. 7 i këtij Vendimi.

14. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton kërkesën e ZPS-së që W04501 të japë dëshmi përmes videokonferencës.

IV. KLASIFIKIMI

15. Trupi Gjykses vëren se Vlerësimi i Zyrës Administrative u dorëzua si konfidencial. Trupi Gjykses urdhëron Zyrën Administrative të dorëzojë një version të redaktuar publik të Vlerësimit të Zyrës Administrative jo më vonë se **të premten, 28 qershor 2024**.

V. VENDIM

16. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **AUTORIZON** W04445-ën dhe W04501-shin të japin dëshmi përmes videokonferencës;
- c) **URDHËRON** Zyrën Administrative të bëjë përgatitjet e nevojshme për dhënien e dëshmive nga W04445 dhe W04501 përmes videokonferencës; dhe
- d) **URDHËRON** Zyrën Administrative të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Vlerësimit të Zyrës Administrative jo më vonë se **të premten, 28 qershor 2024**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 20 qershor 2024

Në Hagë, Holandë.